



AKEP

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE
ELEKTRONIKE DHE POSTARE



**Treguesit Statistikorë të Tregut të
Komunikimeve Elektronike
2021**

AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Drejtoria e Tregjeve dhe Masave Rregullatore

<i>Treguesit kryesorë të volumit të shërbimeve celulare.....</i>	<i>4</i>
<i>Numri i përdoruesve celularë</i>	<i>5</i>
<i>Shërbimet e aksesit broadband në rrjetet celulare 3G/4G.....</i>	<i>6</i>
<i>Trafiku telefonik dhe SMS.....</i>	<i>7</i>
<i>Terminimi i thirrjeve dhe SMS-ve</i>	<i>8</i>
<i>Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve celulare</i>	<i>8</i>
<i>Pjesët e tregut</i>	<i>9</i>
<i>Treguesit kryesorë të volumit të shërbimeve nga rrjetet fikse.....</i>	<i>12</i>
<i>Telefonia fikse</i>	<i>12</i>
<i>Aksesi broadband nga rrjete fikse.....</i>	<i>15</i>
<i>Numri i pajtimtarëve</i>	<i>15</i>
<i>Paketat e integruara (Bundles).....</i>	<i>17</i>
<i>Teknologjia</i>	<i>19</i>
<i>Shpejtësia e aksesit broadband.....</i>	<i>19</i>
<i>Përdorimi i përbashkët i infrastrukturës aktive dhe pasive në rrjetet fikse</i>	<i>20</i>
<i>Të ardhurat dhe investimet</i>	<i>21</i>

Lista e Figurave

Figura 1: Treguesit kryesorë të volumit të shërbimeve celulare 2016-2021	4
Figura 2: Numri i përdoruesve celularë aktivë dhe karta SIM 2016-2021	5
Figura 3: Struktura e thirrjeve dalëse celulare sipas destinacionit 2016-2021	7
Figura 4: Ecuria trafikut mujor on-net/off-net 2016-2021	7
Figura 5: Terminimi i thirrjeve hyrëse kombëtare dhe ndërkombëtare në rrjetet celulare (në minuta)	8
Figura 6: Ecuria e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse 2016-2021	13
Figura 7: Norma e penetrimit të Telefonisë Fikse sipas qarqeve dhe zonave Urbane/Rurale (2021)	13
Figura 8: Penetrimi i aksesit broadband nga rrjete fikse sipas popullsisë dhe familjeve	16
Figura 9: Penetrimi i aksesit broadband nga rrjete fikse sipas Qarqeve (2021)	17
Figura 10: Numri i pajtimtarëve që kanë akses në shërbime të integruara (Telefoni, Internet dhe TV)	18
Figura 11: Lidhjet broadband fiks sipas teknologjisë Shqipëri 2021	19
Figura 12: Shpërndarja e pajtimtarëve me akses broadband fiks sipas shpejtësisë	20
Figura 13: Të ardhurat e sipërmarrësve të komunikimeve elektronike nga rrjetete celulare dhe ato fikse	21
Figura 14: Të ardhurat nga komunikimet elektronike për vitin 2021 sipas operatorëve kryesorë (milionë lek)	22
Figura 15: Të ardhurat totale të operatorëve celular 2016-2021 (milionë lek)	23
Figura 16: Të ardhurat me shumicë dhe pakicë nga rrjetet celulare (milionë lek)	24
Figura 17: Të ardhurat nga ofruesit e shërbimeve elektronike nga rrjetet fikse për operatorët kryesorë (milionë lek)	25

Lista e Tabelave

Tabela 1: Numri i pajtimtarëve me akses broadband 3G/4G	6
Tabela 2: Përdorimi mesatar mujor i thirrjeve (minuta), SMS (numër), Data (GB)	9
Tabela 3: Pjesët e tregut për treguesit kryesor të shërbimeve celulare	9
Tabela 4: Pjesët e tregut sipas numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse 2016 - 2021	13
Tabela 5: Numri i linjave të telefonisë fikse sipas qarqeve dhe operatorëve	14
Tabela 6: Ecuria e numrit të pajtimtarëve të aksesit Broadband nga rrjete Fikse 2016-2021	15
Tabela 7: Numri i pajtimtarëve të Albtelcom me shërbime të integruara (2016-2021)	18
Tabela 8: Ofrimi me shumicë Linja/kapacitete me qira 2016-2021	21

Shërbimet e komunikimeve elektronike mobile dhe rrjeteve fikse

Bazuar në rregulloren Nr.12, datë 07.04.2010 “Për të dhënat statistikore dhe financiare periodike të sipërmarrësve të rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”, e ndryshuar, të gjithë sipërmarrësit e autorizuar për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike të rrjeteve fikse dhe mobile janë të detyruar të raportojnë në AKEP në mënyrë periodike të dhënat e tyre statistikore dhe financiare sipas afateve të përcaktuara nga kjo rregullore.

Ky raport është përgatitur duke iu referuar të dhënave më të fundit të dërguara nga operatorët celular, si dhe të dhënave të Operatorëve Alternativ. Në disa raste AKEP nuk mund të dallojë parregullsitë e raportimit të të dhënave deri në momentin kur këto të dhëna do të krahasohen në periudhat në vijim. AKEP nuk mban përgjegjësi për cilësinë e të dhënave të raportuara nga operatorët. Për shkak të ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave, jo të gjithë treguesit e raportuar nga operatorët publikohen nga AKEP. Mund të ekzistojë një mospërputhje e vogël ndërmjet shumës së përbërësve dhe totalit të paraqitur nëpër tabela për shkak të rumbullakimeve. Për këtë periudhë janë përdorur raportimet e 229 sipërmarrësve që ushtrojnë aktivitetet në ofrimin e shërbimeve të rrjeteve celulare, telefoni fikse dhe internet.

Gjatë vitit 2021, shërbimet e komunikimeve elektronike kanë vijuar të jenë mbështetës të rëndësishëm të lehtësimit të komunikimit ndërmjet kategorive të ndryshme të konsumatorit fundor me Qeverinë, bizneset, si dhe aktorëve të tjerë ndërlidhës të sferës ekonomiko-shoqërore. Përshtatja e aktorëve të tregut të komunikimeve elektronike ndaj nevojës për të qënë mbështetës të rëndësishëm në rrethanat e reja që u krijuan pas situatës pandemike e shkaktuar nga COVID-19, në një masë të konsiderueshme ka bërë të mundur vijimin e praktikës së ofrimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike me të njëjtat standarde profesionale si gjatë vitit 2020. Zhvillimet periodike të tregut të komunikimeve elektronike kushtëzohen jo vetëm nga tendenca e tij për të të zhdërvjelltësuar konkurrencën efiçente, pavarësisht sfidave të krijuara në situatën pandemike dhe shtysave të brendshme të vetë tregut, por edhe si nevojë e brendshme për të qënë në koherencë me kërkesat gjithnjë në rritje që sjell zhvillimi i novacionit dhe teknologjisë në fushën përkatëse, gjë e cila impakton nevojën e operatorëve celularë dhe të rrjeteve fikse për të investuar në përmirësimin e kapaciteteve të tyre për ofrimin e shërbimeve kryesisht të internetit.

Treguesit kryesorë të volumit të shërbimeve celulare

Aktualisht në tregun e ofrimit të shërbimeve celulare në Shqipëri ushtrojnë aktivitetin tre sipërmarrës: Albtelecom Sh.a, One Telecommunications Sh.a dhe Vodafone Albania Sh.a. Të tre sipërmarrësit kanë raportuar të dhënat sipas afateve të përcaktuara në rregulloren përkatëse.

Për shkak të karakteristikave të aksesit dhe mbulimit më të gjerë se rrjetet fikse, ofruesit e shërbimeve celulare kanë vijuar të luajnë një rol mjaft të rëndësishëm në përballimin e kushteve të vështira të shkaktuar nga pandemia COVID-19 gjatë vitit 2021.

Në vijim paraqitet ecuria për disa nga treguesit kryesorë të volumit të shërbimeve celulare për vitet 2015-2021 dhe norma e ndryshimit vjetor në vitin 2021.

Figura 1: Treguesit kryesorë të volumit të shërbimeve celulare 2016-2021

Viti	2016	2017	2018	2019	2020	2021	Ndryshimi 2021/2020
Numri i përdoruesve të telefonisë celulare:							
- sipas kartave SIM	5,280,990	5,558,492	4,143,603	3,378,886	3,337,824	3,484,158	4.38%
- Përdorues aktivë	3,490,686	3,625,699	2,714,878	2,630,076	2,618,880	2,635,466	0.63%
Numri përdoruesve me akses broadband 3G/4G:							
- Totali	2,739,550	3,345,045	2,657,015	2,462,057	2,469,850	2,789,023	12.92%
- Përdorues aktivë	1,686,354	2,030,978	1,809,996	1,789,158	1,998,579	2,056,444	2.90%
Thirrje telefonike dalëse të përdoruesve celularë (minuta)	6,793,769,155	6,619,674,715	6,019,006,073	5,494,296,034	5,286,361,927	5,602,663,590	5.98%
Thirrje hyrëse kombëtare (minuta)	2,522,840,417	2,893,847,082	2,525,099,112	2,318,816,619	2,306,339,577	2,501,744,337	8.47%
Thirrje hyrëse ndërkombëtare (minuta)	300,227,063	168,753,020	164,608,604	213,311,650	187,708,510	144,033,382	-23.27%
Numri mesazheve SMS të dërguara nga përdoruesit	1,610,322,977	1,400,142,526	1,212,559,068	967,833,263	660,604,925	555,701,627	-15.88%
Volumi total i të dhënave të transmetuara në rrjete celulare (GB)	26,753,639	45,901,117	60,051,808	69,135,490	88,950,833	155,585,664	74.91%

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Treguesit që kanë shënuar rritje të konsiderueshme gjatë vitit 2021:

- volumi i të dhënave të transmetuara nëpërmjet internetit në rrjetet mobile, volumi i cili është rritur me rreth 74.9% krahasuar me vitin 2020.
- numri i përdoruesve me akses broadband 3G/4G rreth 12.9% më shumë.

Gjatë vitit 2021, rritjen më të madhe të volumit të të dhënave 'Data' e ka pasur One Telecommunications me rreth 146%, e ndjekur nga Albtelecom me 59% dhe Vodafone Albania me 53%. Rritja e përdorimit të internetit nëpërmjet telefonave celularë evidenton faktin se tashmë telefonat celularë të pajisur me karta SIM e kanë ridimensionuar rolin e tyre duke kaluar nga përdorimi tradicional për kryerjen e thirrjeve zanore, drejt ofrimit të aksesit të gjerë në botën virtuale (shfletim informacionesh, transmetim të dhënash, kryerje e thirrjeve audio/video, sms, etj.).

Treguesit e tjerë kryesor për vitin 2021 kanë shënuar rritje krahasuar me vitin 2020, si më poshtë:

- numri i pajtimtarëve sipas kartave SIM rreth 4.38%;
- numri i përdoruesve aktivë të shërbimeve celulare rreth 0.63%;
- numri i përdoruesve aktiv me akses broadband 3G/4G rreth 2.9%;

- volumi i thirrjeve dalëse celulare me rreth 5.98%;
- volumi i thirrjeve hyrëse kombëtare me rreth 8.47%.

Rritja e përdorimit të internetit u shoqërua me ulje të:


- volumi i trafikut të thirrjeve hyrëse ndërkombëtare me rreth 23.27%;
- numrin i SMS të dërguara nga përdoruesit me rreth 15.88%.

Ashtu siç është evidentuar edhe në raportet pararendëse të AKEP, rënia e përdorimit të këtyre treguesve është pasojë edhe e përdorimit në masë i aplikacioneve OTT (*whatsapp, Viber, Messenger, Skype, etj.*) nëpërmjet të cilëve dërgohen mesazhe tekst dhe kryhen thirrje zanore dhe *video calls*. Komunikimi nëpërmjet këtyre aplikacioneve ka ardhur gjithnjë në rritje edhe si rezultat i përmirësimit të shërbimeve të ofruara nga operatorët të rrjeteve 4G dhe 4G+ të cilat mundësojnë transmetim me cilësi më të mirë si të mesazheve ashtu edhe të thirrjeve (video dhe audio) nëpërmjet këtyre aplikacioneve.

Numri i përdoruesve celularë

Nga të dhënat e ecurisë së numrit të përdoruesve celularë sipas viteve vërehet se numri i pajtimtarëve të shërbimeve celulare ka shënuar rritje nga viti 2014 deri në fund të vitit 2017, për t'u ndjekur nga një rënie e theksuar të këtyre treguesve nga tremujori i parë 2018 e në vijim deri në fundin e tremujorit të dytë 2020. Nga tremujori i dytë 2020 deri në fund të tremujorit të katërt 2020 numri i pajtimtarëve të shërbimeve celulare ka shënuar rritje, për tu ndjekur nga një rënie deri në fund të tremujorit të dytë 2021.

Figura 2: Numri i përdoruesve celularë aktivë dhe karta SIM 2016-2021



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2021 vërehet një rënie e treguesve kryesor krahasuar me periudhën e mëparshme T4 2020, rënie që ka vijuar edhe gjatë tremujorit të dytë, për tu ndjekur nga një rritje në fund të tremujorit të tretë të vitit.

Ndërkohë që gjatë tremujorit të katërt të vitit 2021 vihet re rritje e të gjithë treguesve kryesor krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2020.

Shërbimet e aksesit broadband në rrjetet celulare 3G/4G

Siç është përmendur edhe më sipër, ofrimi i shërbimit të internetit ka qenë një ndër shtyllat kryesore që ka vijuar të ndikojë pozitivisht në përballimin e vështirësive të krijuara nga situata e pandemisë edhe gjatë vitit 2021. Numri total i përdoruesve të rrjeteve celulare që kanë përdorur aksesin broadband në internet gjatë vitit 2021 paraqitet si vijon:

- rreth 2.7 milion përdorues që e kanë përdorur rrjetin të paktën një herë gjatë vitit 2021;
- rreth 2 milion përdorues aktivë (përdorim të internetit në tre muajt e fundit).

Tabela 1: Numri i pajtimtarëve me akses broadband 3G/4G

Viti	One Telecommunications	Vodafone Albania	Albtelecom	Plus Communications	Total	Norma e pentrimt për popullsi
2016	460,221	921,854	231,321	72,958	1,686,354	60%
2017	613,886	1,030,614	282,077	104,401	2,030,978	72%
2018	605,984	931,730	272,282		1,809,996	63%
2019	567,572	940,949	280,737		1,789,258	63%
2020	718,631	981,483	298,465		1,998,579	70%
2021	825,707	925,967	304,770		2,056,444	73%

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.


Operatorët me rrjete 3G/4G kanë pasur rritje të numrit të përdoruesve aktivë të shërbimeve akses broadband nëpërmjet aparateve celulare, ku në fund të vitit 2021 kjo shifër arriti në rreth 2 milion, krahasuar me 1.8 milion në fund të vitit 2020.

Ndërsa numri i përdoruesve aktivë nëpërmjet kartave USB/modem për vitin 2021 arriti në rreth 18 mijë përdorues duke shënuar një rënie me rreth 83% në krahasim me vitin 2020. Rënia e përdorimit të internetit nëpërmjet kartave USB/modem ndikohet nga rritja e ofrimit të shërbimit të internetit nëpërmjet pajisjeve celulare, si edhe rritja mjaft e madhe e ofrimit të shërbimit broadband nga rrjetet fikse.

Trafiku telefonik dhe SMS

Sasia totale e thirrjeve telefonike të gjeneruara nga përdoruesit celularë gjatë vitit 2021 ishte rreth 5.6 miliard minuta, e cila përbën një rritje me 5.98% në krahasim me vitin 2020 (5.3 miliard minuta).

Figura 3: Struktura e thirrjeve dalëse celulare sipas destinacionit 2016-2021




Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Gjatë vitit 2021, volumi i thirrjeve kombëtare drejt rrjeteve celulare (on-net dhe off-net) ka shënuar rritje, krahasuar me vitin 2020:

- sasia e thirrjeve on-net u rrit me 3%,
- thirrjet off-net u rrit me 10%.

Figura 4: Ecuria trafikut mujor mujor on-net/off-net 2016-2021



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Bazuar në masat e ndërmarra nga AKEP për mos-diskriminim të tarifave të thirrjeve brenda rjetit dhe drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare, rezultojnë që gjatë vitit 2021, rreth 44% e thirrjeve të realizuara kanë qenë drejt operatorëve të tjerë celularë ‘off-net dhe rreth 55%


brenda rrjetit ‘on-net’, duke shënuar një ndryshim të lehtë me rreth 1 pikë përqindje nga viti i kaluar për të dy treguesit.

Numri i SMS-ve të dërguara gjatë vitit 2021 ishte rreth 556 milion ose rreth 15.88% më pak se në vitin e kaluar.

Terminimi i thirrjeve dhe SMS-ve

Sasia totale e thirrjeve hyrëse të terminuara në vitin 2021 ishte rreth 2.64 miliardë minuta, që përbën rritje me 6% në krahasim me vitin paraardhës. Terminimi i thirrjeve kombëtare u rrit me 0.87% për thirrjet nga rrjetet fikse dhe me 8.58% për thirrjet nga rrjetet e tjera celulare. Terminimi i thirrjeve hyrëse ndërkombëtare pësoi rënie me 23% krahasuar me vitin 2020.

Figura 5: Terminimi i thirrjeve hyrëse kombëtare dhe ndërkombëtare në rrjetet celulare (në minuta)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

SMS- të e terminuara kanë pësuar rënie me 5% gjatë vitit 2021.

Përdorimi mesatar mujor i shërbimeve celulare

Vlen të theksohet se në ndryshim nga viti 2020, gjatë vitit 2021:

- volumi mesatar mujor i thirrjeve për përdorues ka shënuar rritje me rreth 5% duke arritur në 360 minuta thirrje hyrëse dhe dalëse,
- volumi i konsumit mesatar mujor të internetit është rritur me përafërsisht 64% duke arritur në rreth 6.39 GB në muaj.

Tabela 2: Përdorimi mesatar mujor i thirrjeve (minuta), SMS (numër), Data (GB)

	2016	2017	2018	2019	2020	2021	Ndryshimi 2021/2020
Thirrje dalëse	166	155	158	171	168	178	5.78%
Thirrje të marra	169	156	161	177	174	182	4.60%
MOU	335	311	319	348	342	360	5.18%
SMS Dalese	39	33	31	30	21	18	-16.06%
Trafik Data (GB)	1.5	2.1	2.6	3.2	3.9	6.4	63.55%

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Gjatë vitit 2021, një përdorues celular aktiv ka kryer mesatarisht 178 minuta thirrje dalëse në muaj, ka dërguar 18 mesazhe SMS dhe ka konsumuar rreth 6.39 GB në internet broadband.

Faktori kryesor që ndikon në mesataren e SMS-ve është rritja e përdorimit të shërbimeve të komunikimit (sms, voice, video) nëpërmjet aplikacioneve OTT.

Këto vlera përdorimi janë më të vogla nëse si numër përdoruesish celular i referohemi numrit total të përdoruesve sipas kartave SIM.

Pjesët e tregut

Në vijimësi zhvillimi i tregjeve bazohet në ndërtimin e strategjive të reja tregtare dhe inovative me fokus teknologjinë. Këto strategji modelojnë jo vetëm zhvillimin e produktit apo shërbimit që ofrohet për konsumatorin por edhe vetë përqasjen e konsumatorit ndaj risive që sjell tregu. Komplexiteti i tregut në identifikimin e aftësive strategjike, në ruajtjen e mirë dhe përdorimin e efikasitetit të kostos, në përpjekjet e aktorëve të tregut për të arritur dhe mbajtur avantazhet konkurruese, në nevojën për diagnostikimin e duhur të aftësive strategjike dhe perfeksionimin e menaxhimit të tyre, janë ngushtësisht të lidhura me politikat sektoriale.

Në këtë këndvështrim duhen vlerësuar edhe investimet e operatorëve celularë dhe fiks të kryera gjatë viteve të fundit, të cilat kanë dhënë efekt edhe në nxitjen e konkurrencës midis operatorëve ku vërehen lëvizje për sa i përket pjesëve të tregut të secilit operator.

Tabela 3: Pjesët e tregut për treguesit kryesor të shërbimeve celulare

	One Telecommunications	Vodafone	Albtelecom	Plus	HHI	
Përdorues shërbime celulare (karta SIM përfshirë Broadband Data Card)	2016	32%	49%	14%	4%	3,691
	2017	32%	49%	14%	5%	3,676
	2018	34%	50%	15%		3,954
	2019	33%	50%	17%		3,883
	2020	37%	47%	16%		3,833
	2021	40%	44%	16%		3,811

		One Telecommunications	Vodafone	Albtelecom	Plus	HHI
Përdorues Aktivë të shërbimeve celulare	2016	31%	51%	13%	5%	3,724
	2017	34%	48%	13%	6%	3,620
	2018	37%	47%	16%		3,842
	2019	36%	48%	16%		3,849
	2020	37%	47%	16%		3,829
	2021	39%	45%	15%		3,834
		One Telecommunications	Vodafone	Albtelecom	Plus	HHI
Përdorues aktivë broadband (3G/4G)	2016	27%	55%	14%	4%	3,944
	2017	30%	51%	14%	5%	3,708
	2018	37%	47%	16%		3,842
	2019	32%	53%	16%		4,018
	2020	36%	49%	15%		3,928
	2021	40%	45%	15%		3,859
		One Telecommunications	Vodafone	Albtelecom	Plus	HHI
Thirrje dalëse	2016	34%	52%	11%	4%	3,940
	2017	34%	48%	11%	7%	3,646
	2018	35%	52%	13%		4,093
	2019	34%	53%	13%		4,112
	2020	34%	53%	13%		4,166
	2021	39%	50%	11%		4,151
		One Telecommunications	Vodafone	Albtelecom	Plus	HHI
SMS dalëse	2016	21%	67%	9%	3%	4,988
	2017	25%	60%	10%	5%	4,325
	2018	27%	61%	12%		4,602
	2019	26%	60%	14%		4,483
	2020	26%	60%	14%		4,464
	2021	28%	58%	14%		4,340
		One Telecommunications	Vodafone	Albtelecom	Plus	HHI
	2016	21%	55%	22%	2%	3,937
	2017	24%	55%	18%	2%	3,970

Trafiku të dhëna (Gbyte)	2018	26%	55%	19%	4,086	
	2019	24%	59%	16%	4,113	
	2020	23%	64%	13%	4,675	
	2021	32%	56%	12%	4,201	
One Telecommunications Vodafone Albtelecom Plus HHI						
Të ardhura totale nga komunikimet	2016	31%	49%	12%	9%	3,522
	2017	30%	49%	12%	8%	3,549
	2018	32%	54%	14%		4,137
	2019	31%	54%	14%		4,149
	2020	34%	53%	13%		4,129
	2021	35%	52%	13%		4,110
One Telecommunications Vodafone Albtelecom Plus HHI						
Të ardhura retail	2016	28%	56%	12%	5%	4,052
	2017	31%	51%	13%	5%	3,746
	2018	32%	55%	14%		4,173
	2019	31%	55%	14%		4,156
	2020	33%	54%	14%		4,139
	2021	35%	53%	12%		4,178

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Edhe gjatë vitit 2021, sipërmarrësi Vodafone Albania vazhdon të jetë operatori me pjesën më të madhe të tregut për të gjithë treguesit kryesorë të shërbimeve të komunikimeve elektronike mobile. Megjithatë, vlen të theksohet se ai ka shënuar rënie të lehtë për pjesën më të madhe të këtyre treguesve krahasuar me vitin 2020. Konkretisht pjesët e tregut për vitin 2021 për sipërmarrësin Vodafone Albania sh.a, variojnë me:

- Rreth 44% të pjesës së tregut për përdoruesit e SIM card, nga rreth 47% në vitin 2020;
- mbi 45% të pjesës së tregut për përdoruesit e SIM card aktivë, nga rreth 47% në vitin 2020;
- rreth 50% të tregut për thirrjet dalëse, nga rreth 53% në vitin 2020;
- rreth 56% të tregut për volumin e të dhënave (internetit) nga rreth 64% në vitin 2020;
- rreth 45% të tregut për përdoruesit aktivë të internetit (broadband), nga rreth 49% në vitin 2020;
- 52% dhe 53% të tregut përkatësisht të të ardhurave totale dhe ato nga shërbimet me pakicë;

Sipërmarrësi One Telecommunications, ka vijuar rritjen në treguesit kryesor gjatë vitit 2021 duke i dhënë një nxitje konkurrencës në tregun e shërbimeve celulare. Kjo gjë pasqyrohet edhe në rritjen e pjesëve të tregut për disa nga treguesit kryesorë:

- rreth 40% të pjesëve të tregut për përdoruesit e SIM card, nga rreth 37% në vitin 2020;
- rreth 39% të pjesës së tregut për përdoruesit e SIM card aktivë, nga rreth 37% në vitin 2020;
- rreth 39% të tregut për thirrjet dalëse mobile, nga rreth 34% në vitin 2020;
- rreth 32% të tregut për volumin e të dhënave (internetit) nga rreth 23% në vitin 2020;
- rreth 40% të tregut për përdoruesit aktivë të internetit (broadband), nga rreth 36% në vitin 2020;
- rreth 35% të tregut përkatësisht të të ardhurave totale dhe ato nga shërbimet me pakicë, nga rreth 33-34% për të dy treguesit në vitin 2020.

Sipërmarrësi Albtelecom sha,, gjatë vitit 2021 nuk ka mundur të përmirësojë pozitat e tij në treg dhe ka shënuar rënie të lehtë të treguesve kryesorë krahasuar me vitin 2020. Rënien më të ndjeshme e ka shënuar për treguesin e thirrjeve dalëse:

- rreth 16% të pjesëve të tregut për përdoruesit e SIM card, në të njëjtin nivel me vitin 2020;
- rreth 15% të pjesës së tregut për përdoruesit e SIM card aktivë, duke shënuar ulje me 1 pikë përqindje krahasuar me vitin 2020;
- rreth 11% të tregut për thirrjet dalëse mobile, nga rreth 13% në vitin 2020;
- rreth 12% të tregut për volumin e të dhënave (internetit), nga rreth 13% në vitin 2020;
- rreth 15% të tregut për përdoruesit aktivë të internetit (broadband), në të njëjtin nivel me vitin 2020;
- rreth 13% dhe 12% të tregut përkatësisht të të ardhurave totale dhe ato nga shërbimet me pakicë nga rreth 13-14% për të dy treguesit në vitin 2020.

Treguesit kryesorë të volumit të shërbimeve nga rrjetet fikse

Telefonia fikse

Sipas të dhënave statistikore të depozituara në AKEP rezulton se numri i operatorëve të autorizuar të rrjeteve të telefonisë fikse, që kanë raportuar se kanë pasur aktivitetet gjatë 2021 në telefoninë fikse është rreth 33 dhe 208 operatorë kanë ofruar shërbimet broadband fikse.


Pjesa më e madhe e operatorëve alternativ janë të vegjël dhe me prani shumë të kufizuar rrjeti në zona urbane apo rurale afër qendrave urbane.

Ofrimi i shërbimeve të telefonisë fikse për kryerjen e thirrjeve *voice* gjithnjë e më shumë e ka ulur pjesën e saj në treg, kjo edhe si rezultat i lehtësisë dhe rritjes së vazhdueshme të shërbimeve nga rrjetet celulare. Shërbimi i telefonisë fikse ofrohet kryesisht si pjesë e paketave të shërbimeve të rrjeteve fikse të kombinuara (internet, IPTV, telefoni fikse dhe së fundmi edhe mobile), trendi rënës për këtë tregues evidentohet në të gjitha ekonomitë e botës.

Numri i pajtimtarëve të telefonisë fikse në Shqipëri në vitin 2021 ka pësuar një rënie rreth 12%, konkretisht nga 223 mijë në fund të vitit 2020 në 197 mijë në fund të vitit 2021.

Norma e penetrimit për telefoninë fikse (numër pajtimtarësh për 100 banorë) në fund të vitit 2021 arriti në 7%, duke mbetur në të njëjtin nivel si në vitin 2020 kur ky tregues ishte 7.9%.

Figura 6: Ecuria e numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse 2016-2021



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Tabela 4: Pjesët e tregut sipas numrit të pajtimtarëve të telefonisë fikse 2016 - 2021

	Albtelcom	Vodafone Albania	ASC	Abissnet	Nisatel	OA te tjere	Total
2016	176,733	13,946	37,765	3,823	4,306	12,067	248,64
2017	171,516	15,282	42,829	3,982	2,470	10,641	246,72
2018	177,129	11,637	40,377	4,049	4,100	11,339	248,63
2019	176,653	11,409	35,558	4,095	4,098	11,046	242,85
2020	168,142	8,524	30,399	4,154	4,122	8,128	223,46
2021	152,829	8,355	20,583	4,191	4,164	7,568	197,69
Ndryshimi 2021/2020	-9%	-2%	-32%	1%	1%	-7%	-12%


Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Siç vërehet nga të dhënat e paraqitura në tabelën sa më sipër, operatori me pjesën më të madhe në treg është Albtelcom rreth 77%, i ndjekur nga ASC me rreth 10%, Vodafone Albania me rreth 4%, OA të tjerë me 4% dhe Nisatel dhe Abissnet me nga 2%. Ajo që konstatohet është se edhe për vitin 2021 pjesa e pajtimtarëve për të gjithë operatorët kryesor ka pësuar rënie krahasuar me vitin 2020, ndërkohë që Abissnet dhe Nisatel ka pasur rritje me rreth 1%.

Në figurën në vijim paraqitet norma e penetrimit të telefonisë fikse sipas Qarqeve në nivel urban dhe rural.

Të dhënat për numrin e pajtimtarëve sipas qarqeve tregojnë se rreth 54% e të gjithë pajtimtarëve të telefonisë fikse janë në qarkun e Tiranës. Diferenca në nivelin e përdorimit në zona urbane dhe rurale është e madhe.

Figura 7: Norma e penetrimit të Telefonisë Fikse sipas qarqeve dhe zonave Urbane/Rurale (2021)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Sasia totale e thirrjeve të gjeneruara nga rrjetet fikse në vitin 2021 u rrit me 5%, si rrjedhojë e rritjes së sasisë së thirrjeve telefonike të gjeneruara nga pajtimtarët e rrjetit fiks të Albtelecom, gjithashtu mesatarja e minutave të thirrjeve në muaj për përdorues të rrjetit fiks të Albtelecom është rritur nga 33 minuta në vitin 2020 në 37 minuta në vitin 2021.

Tabela 5: Numri i linjave të telefonisë fikse sipas qarqeve dhe operatorëve

Qarku	Total	Albtelecom	Vodafone	ASC	OA të tjerë
Berat	7,554	7,206	154	0	194
Dibër	2,601	2,598	1	2	0
Durrës	15,818	12,639	475	2354	350
Elbasan	6,959	6,400	433	78	48
Gjirokastrë	7,393	6,549	5	0	839
Fier	6,868	5,731	686	165	286
Korçë	13,505	12,289	841	7	368
Kukës	2,459	2,456	0	0	3
Lezhë	6,122	5,080	6	1,011	25
Shkodër	7,476	5,588	576	3	1,309
Tiranë	106,219	76,567	4,619	16,842	8,191
Vlorë	14,716	9,726	559	121	4,310

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Albtelecom është operatori i vetëm me shtrirje të rrjetit në të gjitha qarqet e vendit, si dhe zotëron një pjesë të konsiderueshme të infrastrukturës kombëtare për ofrimin e shërbimeve nga rrjetet fikse. Operatorët e tjerë, janë të përqendruar në qarqet më të mëdha të vendit, kryesisht zonat me densitet të lartë të popullsisë.

Aksesi broadband nga rrjete fikse**Numri i pajtimtarëve**

Tregu i ofrimit të shërbimeve broadband nga rrjetet fikse karakterizohet nga një numër i lartë pjesëmarrësish dhe si rezultat në këtë treg konkurrueshmëria është e lartë. Vetëm disa nga subjektet pjesë e këtij tregu kanë shtrirje të gjerë në disa qarqe të vendit, pjesa tjetër konkurrojnë në segmente më të vogla kryesisht janë ofrues lokalë.

Numri pajtimtarëve me akses *broadband* fiks në fund të vitit 2021 për herë të parë tejkaloi shifrën e 550 mijë pajtimtarëve, duke u rritur me rreth 10% në krahasim me vitin 2020.

Tabela 6: Ecuria e numrit të pajtimtarëve të aksesit *Broadband* nga rrjete Fikse 2016-2021

	Albtelecom	Vodafone Albania	Abissnet	ASC	Nisatel	Digicom	I.B.C	Bleta	OA të tjerë	Total
2016	109,851	52,442	29,497	37,650	7,421	N/A	1,230	5,500	22,788	266,379
2017	120,204	55,860	28,633	46,118	7,500	6,378	1,200	7,000	30,719	303,612
2018	129,329	64,020	37,055	49,359	13,473	14,322	3,200	7,500	43,689	361,947
2019	133,515	74,708	40,849	52,773	13,809	18,516	4,900	8,000	89,122	436,192
2020	128,877	95,558	41,576	58,529	17,609	22,400	6,600	9,700	128,088	508,937
2021	118,130	111,072	42,338	59,275	20,586	24,850	11,565	11,000	160,578	559,394
Ndryshimi 2021/2020	-8%	16%	2%	1%	17%	11%	75%	13%	25%	10%

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Tabela më sipër paraqet ecurinë e numrit të pajtimtarëve me akses broadband në periudhën 2016-2021 për operatorët kryesor në treg.

Për vitin 2021 operatorët me pjesët më të madhe të tregut fiks janë renditur si më poshtë:


- Albtelecom zotëron rreth 21% pjesë tregu;
- Vodafone Albania zotëron 20% pjesë tregu;
- ASC zotëron 11% pjesë tregu;
- Abissnet me rreth 8% pjesë tregu;
- Digicom zotëron rreth 4% pjesë tregu;
- Nisatel zotëron 4% pjesë tregu;
- I.B.C zotëron 2% pjesë tregu;
- Bleta zotëron 2% pjesë tregu;
- OA (operator të tjerë), me 29% të tregut.

Gjatë viteve të fundit është vërejtur ofrimi i shërbimeve të kombinuara të rrjeteve fikse me ato mobile, duke promovuar paketa që sjellin përfitime në të dy tregjet nëse përdorin shërbime të kombinuara.

Grafiku i mëposhtëm paraqet ecurinë e penetrimit të aksesit broadband nga rrjete fikse për popullsi dhe për numër familjesh gjatë periudhës 2016-2021. Në vitin 2021 norma e penetrimit të aksesit broadband nga rrjete fikse ishte rreth 77% për familje dhe 19.7% për popullsi.

Figura e mëposhtme paraqet ecurinë e penetrimit të aksesit broadband nga rrjete fikse për popullsi gjatë periudhës 2011-2021.

Figura 8: Penetrimi i aksesit broadband nga rrjete fikse sipas popullsisë dhe familjeve¹




Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Bazuar në të dhënat rajonale në 2021 vërehet se qarqet me normat më të larta të penetrimit urban janë Tirana dhe Korça, përkatësisht me nga 43.55% dhe 27.8% ndërsa Durrësi është qarku që ka normën më të lartë të penetrimit rural rreth 23%, i ndjekur nga Tirana, Shkodra dhe Lezha me nga 10%.

¹ Të dhënat e popullsisë sipas INSTAT, numri familjeve sipas Census 2011.

Figura 9: Penetrimi i aksesit broadband nga rrjete fikse sipas Qarqeve (2021)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Të dhënat e mësipërme tregojnë për një normë relativisht të ulët të penetrimit të internetit nëpërmjet rrjeteve fikse në zonat urbane mesatarisht 30% dhe në zonat rurale mesatarisht 8%.

Paketat e integruara (Bundles)


Strategjia e konsumit drejt paketave bundle me shërbime të integruara thirrje telefonike kombëtare, SMS dhe akses në Internet e shoqëruar me ndryshimet e cituara ka çuar në krahasim më të lehtë të paketave të një operatori dhe ato midis operatorëve të ndryshëm dhe kontroll më të lehtë të shpenzimeve nga përdoruesit celularë. Tendenca e operatorëve celularë në ofrimin e paketave për përdoruesit me parapagim është ofrimi i tyre në bazë konsumi 1 ditore, javor dhe mujor (30 ditore), duke përfshirë në shumicën e tyre përveç thirrjeve telefonike dhe SMS edhe akses në Internet. Këto paketa krijojnë mundësinë e zgjedhjes për përdoruesit me parapagim dhe janë lehtësisht të krahasueshme në bazë të çmimit, njësive të konsumit të përfshira në paketa dhe kohëzgjatjes së tyre.

Ofrimi i shërbimeve të rrjeteve fikse me paketa të integruara të shërbimeve të aksesit në internet, telefonisë fikse dhe TV (CaTV ose IPTV), rezulton të jetë forma predominuese e konkurrencës midis operatorëve të rrjeteve fikse.

Numri i pajtimtarëve të rrjeteve fikse që kanë akses në shërbime të integruara dyfishe ose trefishe (kombinim Telefoni/Internet/ TV) në fund të vitit 2021 arriti në rreth 302 mijë, rreth 3% më shumë se në vitin 2020.

Në vitin 2021 pajtimtarët me paketa të integruara përbënin 54% të pajtimtarëve me akses broadband në rrjete fikse, ndërsa 30% e pajtimtarëve me paketa të integruara janë me paketa trefishe (Telefoni, Internet dhe TV).

Figura 10: Numri i pajtimtarëve që kanë akses në shërbime të integruara (Telefoni, Internet dhe TV)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Numri i pajtimtarëve me shërbime të integruara në shporta *triple play* (Telefoni, Internet dhe TV), ka rënie rreth 11% krahasuar me vitin 2020.

Nga të dhënat e paraqitura në figurën e mësipërme, vërehet se përdorimi i shërbimeve të integruara (Internet dhe TV) rezulton të jetë më i përdoruri ndër tre klasifikimet dhe është shoqëruar me një rritje gjatë vitit 2021 në krahasim me vitin 2020 (rreth 7 pp), ndërsa rënie të konsiderueshme ka pasur përdorimi i shërbimeve të integruara (telefoni fikse, Internet dhe TV) i cili arriti në rreth 92 mijë gjatë vitit 2021 ose (rreth 5pp) rënie në krahasim me vitin 2020. Ndërkohë që pjesa e tregut për shërbimet e integruara (Telefoni fikse dhe Internet) ka pësuar rënie me (rreth 4 pp) krahasuar me vitin 2020.

Tabela 7: Numri i pajtimtarëve të Altelecom me shërbime të integruara (2016-2021)

	2016	2017	2018	2019	2020	2021	Ndryshimi 2021/2020
Numri total i pajtimtarëve me akses broadband	109,851	120,204	129,329	133,515	128,877	118,130	-8%
Numri i pajtimtarëve që kanë akses në shërbime të integruara (TV, Internet, telefoni)	109,034	118,050	126,695	130,685	125,873	114,233	-9%
Telefoni fikse dhe Internet	33,673	37,783	42,503	46,609	48,811	48,370	-1%
Telefoni fikse, Internet dhe IPTV	75,361	80,264	84,191	84,056	76,928	65,491	-15%

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.


Tabela e mësipërme paraqet ecurinë e numrit të pajtimtarëve të Altelecom me akses broadband dhe shërbime të integruara në periudhën 2013-2021. Në fund të vitit 2021 rreth 55% e pajtimtarëve me akses broadband të Altelecom ishin pajtimtarë të shportave trefishe (Telefoni, Internet dhe IPTV). Gjatë viteve të fundit është vërejtur ofrimi i shërbimeve të

kombinuara të rrjeteve fikse me ato mobile, duke promovuar paketa që sjellin përfitime në të dy tregjet nëse përdorin shërbime të kombinuara.

Teknologjia

Teknologjia kryesore për ofrimin e aksesit broadband në rrjete fikse është FTTH/FTTB duke shënuar rritje me rreth 36% krahasuar me vitin 2020 e ndjekur nga lidhjet DSL. Shumica e lidhjeve DSL janë me rrjete të kombinuara fibër optike dhe bakri (FTTN/FTTC). Vlen të theksohet se gjithnjë e më shumë sipërmarrësit që ofrojnë shërbimet broadband nga rrjetet fikse po i zhvendosin linjat e tyre nga lidhjet me DSL (dhe kombinimet me të) drejt ofrimit të këtij shërbimi nëpërmjet fibrave optike FTTH/FTTB, të cilat mundësojnë transmetim me shpejtësi dhe cilësi shumë herë më të lartë se DSL. Në fund të vitit 2021 numri i lidhjeve bazuar në teknologjinë DSL- FTTN/FTTC është ulur në rreth 85 mijë nga rreth 170 mijë që numëronte në vitin 2019, sikundër numri i lidhjeve me teknologji FTTH/FTTB në fund të vitit 2021 arriti në mbi 314 mijë nga rreth 142 mijë në vitin 2019.

Figura 11: Lidhjet broadband fiks sipas teknologjisë Shqipëri 2021



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Shpejtësia e aksesit broadband


Përmirësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit të internetit vërehet edhe në tregun e ofrimit të shërbimeve broadband nga rrjetet fikse. Në vitin 2021 rritjen më të madhe e kishte pjesa e pajtimtarëve me lidhje broadband me shpejtësi 100 Mbps -1 Gbps, duke rezultuar në rreth 2.5-fishim të pajtimtarëve krahasuar me vitin 2020, ndjekur nga lidhje broadband me shpejtësi 1 Gbps ose më e madhe me 2-fishim të pajtimtarëve krahasuar me vitin 2020.

Gjatë vitit 2021, pjesa e pajtimtarëve që përdorin shpejtësi më shumë se 10 Mbps ka arritur në 83%, krahasuar me rreth 67% që ishte në vitin 2020. Zhvendosja e pajtimtarëve drejt paketave që ofrojnë shpejtësi interneti më të lartë i mundëson përdoruesve të marrin shërbimet e kërkuara me cilësi më të lartë dhe pa ndërprerje.

Për sa i përket rritjes së niveleve të shpejtësisë së ofruar vlen të theksohet se gjatë vitit 2021 është evidentuar një rritje e konsiderueshme e pajtimtarëve që përdorin rrjet me shpejtësi më të madhe se 100 Mbps, ku nga rreth 15,406 në vitin 2020, ky numër ka arritur në 37,656 në vitin 2021.

Rritja e ndjeshme e numrit të pajtimtarëve që kanë akses në lidhje fikse me shpejtësi më shumë se 100 Mbps është një tregues mjaft pozitiv në funksion të arritjes së objektivave të parashikuara në planin kombëtar të broadband për infrastrukturë digjitale broadband të shpejtësisë së lartë dhe shumë të lartë në të gjithë vendin, për të ngritur themelet për një shoqëri Gigabit.

Figura 12: Shpërndarja e pajtimtarëve me akses broadband fiks sipas shpejtësisë



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Përdorimi i përbashkët i infrastrukturës aktive dhe pasive në rrjetet fikse

Në infrastrukturën aktive të shërbimeve të internetit nga rrjetet fikse me pakicë numri i bizneseve është 5,122 ndërkohë që numri i linjave të dhëna me qira është 3,447 me kapacitet total rreth 194,600 Mbit/s. Ndërsa numri i i operatorëve që ofrojnë akses me shumicë është 62 me 1,018 linja që arrijnë kapacitetin 197,912 Mbit/s.

Për sa i përket infrastrukturës pasive kontribuuesi kryesor ka qenë Albtelecom, i cili ka rritur aksesin në vitin 2021 në 2,088 km dark fibër dhe 71 km tubacione, 247 akses në rrjetin ajror. Sipërmarrësit e tjerë që kanë rritur aksesin në dhënien me qira të fibrës optike të pandriçuar (dark fibër) janë: Albanian Telecommunications Union me 225 km, ASC me 136 km, etj. Ndërsa për sa i përket aksesit në tubacione sipërmarrësit e tjerë që kanë ofruar akses janë: Abissnet me 3 km dhe ASC me 2 km.

Albtelecom është ofruesi kryesor i aksesit me shumicë në elementët aktivë dhe pasivë të infrastrukturës në rrjete fikse. Për vitin 2021, 79% e fibrës optike, 93% e aksesit në tubacione dhe 67% e aksesit në rrjetin ajror janë ofruar nga Albtelecom.

Tabela 8: Ofrimi me shumicë Linja/kapacitete me qira 2016-2021

	2016	2017	2018	2019	2020	2021	Ndryshimi 2021/2020
Ofrim akses në infrastrukturë aktive							
Numri i linjave/lidhjeve të dhëna	532	651	1,466	2,295	1,432	1,018	-29%
Kombëtare	508	633	1,445	2,265	1,404	991	-29%
Ndërkombëtare	24	18	21	30	28	27	-4%
Kapaciteti total i dhënë me qira (Mbps)	44,423	111,311	176,496	208,661	194,143	197,912	2%
Kombëtare	36,464	107,383	174,616	206,148	191,713	195,360	2%
Ndërkombëtare	7,959	3,928	1,880	2,513	2,430	2,552	5%
Ofrim Akses në Infrastrukturë Pasive (Km)							
Dark fiber	1,529	1,397	1,809	1,891	2,084	2,634	26%
Akses në tubacione	74	72	75	78	76	76	0%
Aksesin ne rrjetin ajror	N/A	N/A	N/A	N/A	N/A	367	N/A

Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Treguesit kryesorë të të ardhurave dhe investimeve


Të ardhurat dhe investimet

Nga raportimet e kryera gjatë vitit 2021, ofruesit e shërbimeve të komunikimeve elektronike raportuan në total rreth 36.2 miliardë lekë të ardhura nga komunikimet elektronike, shifër kjo më e lartë se ajo e vitit 2020, si edhe vitit 2019 periudha para pandemike.

Në rritjen e të ardhurave totale të tregut peshën kryesore e ka pasur rritja e të ardhurave të gjeneruara nga ofrimi i shërbimeve të rrjeteve fikse.

Grafiku në vijim paraqet të ardhurat e sipërmarrësve të komunikimeve elektronike totale dhe të ndara sipas tregjeve fikse dhe celulare.

Figura 13: Të ardhurat e sipërmarrësve të komunikimeve elektronike nga rrjetete celulare dhe ato fikse²




² Të dhënat sipas raportimeve të grumbulluara nga operatorët deri më 8.05.2022

Në tregun e ofrimit të shërbimeve celulare gjatë vitit 2021 operatorët kanë raportuar një xhiro prej 24.5 miliardë lekë, e cila përbën një rritje me rreth 3% krahasuar me vitin 2020.


Në lidhje me nivelin e të ardhurave për disa nga sipërmarrësit kryesor në tregun e komunikimeve elektronike na informon figura në vijim.

Figura 14: Të ardhurat nga komunikimet elektronike për vitin 2021 sipas operatorëve kryesorë (milionë lek)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Figura 15: Të ardhurat totale të operatorëve celular 2016-2021 (milionë lek)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Gjatë vitit 2021 të ardhurat e gjeneruara nga ofruesit e shërbimeve mobile paraqiten me një rritje prej rreth 3% nga viti i kaluar, rritjen më të madhe e ka shënuar vjetor One Telecommunications me rreth 8%, Vodafone Albania me një rritje të lehtë prej 0.3%, ndërsa Albtelcom ka rënie me 2%.

Për vitin 2021 ARPM³ (Average revenue Per Minute) ishte 3.05 lekë/minutë ose 3% më pak se viti i mëparshëm, ndërkohë që ARPU⁴ (Average Revenue Per User) ishte 6,526 lekë/përdorues ose 3% më shumë se në vitin 2020.


Në vitin 2021 një përdorues aktiv celular ka paguar mesatarisht rreth 3.05 lekë/minutë (me TVSH) dhe shpenzuar mesatarisht 544 lekë/muaj (me TVSH) për shërbime celulare: 178 minuta thirrje dalëse, 18 SMS dhe rreth 6.4 GB internet.

Për sa i përket treguesve të rezultatit financiar neto vjetor One Telecommunications është shfaqur me rezultat neto pozitiv rreth 191 milionë lekë. Rezultat financiar negativ ka raportuar Vodafone Albania me rreth 1 miliardë lekë humbje, që shënon një rënie të ndjeshme nga fitimi i realizuar vitin e kaluar. Edhe sipërmarrësi Albtelcom gjatë vitit 2021 ka raportuar rezultat financiar negativ me rreth 540 milionë lekë, duke shënuar një përmirësim nga rreth 1.1 miliardë lekë humbje që raportonte për vitin 2020.

³ ARPM (Average revenue Per Minute) llogaritet si raport i të ardhurave nga shërbimet me pakicë me sasinë e minutave dalëse dhe tregon të ardhurat e sipërmarrësit për një minutë.

⁴ ARPU (Average Revenue Per User) llogaritet si raport i të ardhurave nga shërbimet me pakicë me numrin total të përdoruesve aktivë dhe tregon të ardhurat mesatare vjetore të sipërmarrësit për një përdorues.

Figura 16: Të ardhurat me shumicë dhe pakicë nga rrjetet celulare (milionë lek)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Siç vërehet në grafikun më sipër të ardhurat nga shërbimet e ofruara me shumicë për vitin 2021 kanë pësuar një rritje të lehtë, ndërkohë që të ardhurat e gjeneruara nga shërbimet me pakicë kanë vijuar rritjen edhe për periudhën 2020-2021.

Megjithëse në vlerë më të ulët se në vitin 2020, edhe për gjatë vitit 2021 kanë vijuar investimet në rrjetet e ofrimit të shërbimeve celulare, ku vërehet se gjatë këtij viti janë investuar më shumë se 4.6 miliardë lekë. Rreth 82% e vlerës së investimeve të raportuara kanë shkuar në funksion të përmirësimit të infrastrukturës së ofrimit broadband nga rrjetet celulare, gjë e cila reflektohet edhe në përmirësimin e mbulimit me rrjet 3G dhe 4G, si rezultat edhe të volumit të internetit të konsumuar.

Konkretisht për vitin 2021:

- Vodafone Albania ka investuar në total rreth 3.6 miliardë lekë,
- ndjekur nga One Telecommunications me rreth 849 milionë lekë,
- Albtelecom ka investuar në total rreth 176 milionë lekë.


Të ardhurat nga komunikimet elektronike të raportuara nga ofruesit e shërbimeve nga rrjetet fikse për vitin 2021 tejkalojnë vlerën prej 11.7 miliardë lekë. Kjo përbën një rritje me rreth 22% në krahasim me vitin 2020.

Më shumë se 75% e të ardhurave të këtij tregu gjenerohen nga 7 operatorët kryesorë, konkretisht:

- Albtelecom sh.a (31%);
- Vodafone sh.a (22%);
- ASC (6%);
- ATU, Abissnet, dhe Digicom me nga rreth 4%;
- Nisatel (3%);
- Operatorët e tjerë (OA) rreth 25% të të ardhurave të këtij tregu.

Bazuar në raportimet e kryera, përgjatë vitit 2021, sipërmarrësit e rrjeteve fikse kanë kryer rreth 2.5 miliardë lekë investime të cilat kryesisht kanë si destinacion përmirësimin e aksesit të shërbimeve broadband, ku ndër investimet kryesore është fokusimi drejt zhvendosjes së rrjeteve të transmetimit nga teknologjia DSL drejt teknologjisë me fibër.

Figura 17: Të ardhurat nga ofruesit e shërbimeve elektronike nga rrjetet fikse për operatorët kryesorë (milionë lek)



Burimi: Të dhëna të dërguara nga operatorët. Përpunimi AKEP.

Tregu i shërbimeve elektronike është një ndër sektorët që ka një kontribut mjaft të rëndësishëm edhe në punësim. Për vitin 2021 ky treg numëron më shumë se 3,558 të punësuar.